

DELMUR

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS 07 GHS09

Fjalë sinjalizuese: RREZIK

TË PËRDORËT VETËM NGA PËRDORUES PROFESIONISTË

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

Insekticid me spektër të gjërë me bazë piretroide. Karakterizohet nga veprimi i fuqishëm kontakti për kontrollin e insekteve të grupeve të ndryshme sistematike e me mënyra të ndryshme jetese.

Përmbajtja: Deltametrine e pastër 2,8 gr/lit (=25 gr/lit)

Formulimi: Koncentrat i emulsionueshëm (EC)

Masat parambrojtëse:

- P101: Mbajeni në vende të sigurt dhe të pa arritëshme nga fëmijët.
- Ruajeni në vende të thata dhe të freskëta, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Evitoni kontaktet e zgjatura të syve dhe lëkurës me preparatin.
- P270: Mos hani, pini ose tymosni duhan gjatë përdorimit.
- P273: Mos e shperndani në mjedis.
- P280: Vishni doreza mbrojtëse/veshje mbrojtëse/mbrojtëse për sytë/fytyrën.
- EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorim.
- P391: Të mbliidhen materialet e derdhura.
- P501: Të asgjësohen ambalazhet sipas legjislacionit në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Simptomat: bllokun tejçimin nervor duke hiperstimuluar mbaresat neuronale pre-post- sinaptikisht. Ndjeshmëri e veçantë nga ana e pacientëve alergjik dhe azmatik, ashtusikurse dhe femijëve.
- Simptomat në ngarkim të sistemit nervor qendror (SNC): të dridhura, konvulsione etj, irritim i rrugëve frymëmarrëse: tështitje, kollë, bronkospasëm dhe dispne; reaksione alergjike të cilat shkaktojnë: anafilaksi, hipertermi, djersitje, edemë kutane, plasje të eneve periferike të gjakut.
- H315: Shkakton acarim të lëkurës. P302+P352: NË RAST KONTAKTI ME LËKURËN: Lani atë me ujë të bollëshëm dhe sapun. P332+P313: Në rast irritimi të lëkurës: konsultohuni me mjekun.
- H319: Provokon iritim të rëndë në sy. P305+P351+P338: NË RAST KONTAKTI ME SYTË: të lahen me kujdes për disa minuta. Të hiqen lentet nëse është e mundur për të lehtësuar procedurën. Të vazhdohet të lahen sytë. P337+P313: Nëse irritimi i syve vazhdon, konsultohuni me mjekun.
- Terapia: simptomatike dhe rianimimi. Diluenti dhe hidrokarburet mund të provokojnë bronkopolmonit kimik, aritmi kardiake.

Perdorimi:

Pemë frutore farore dhe berthamore: kundër afideve, krimbit të mollës, mizës mesdhetare, me 50 ml/hl (500 ml/ha).

Rrush: kundër tenjave, me 50-62,5 ml/hl (500 ml/ha).

Ulli: kundër tenjës, me 30-40 ml/hl (300-400 ml/ha), në fillim të lulëzimit ose direkt pas formimit të kokrave të para, në intervalin nga depozitimi i vezëve dhe inkubacionit, në funksion të kapjes së meshkujve me kurthe feromonesh.

Agrume: kundër afideve, breshkëzës, mizës mesdhetare, me 50 ml/hl (500 ml/ha).

Patate: kundër bubrecit, me 500 ml/ha.

Domate, patellxhan: kundër afideve, noktuideve, tenjës (*Tuta absoluta*), me 50-133 ml/hl (500 ml/ha).

Spec: kundër afideve, noktuideve, çimkave, krahë bardhave, me 50-133 ml/ha.

Kungullore: kundër afideve, noktuideve, me 50-133 ml/hl (500 ml/ha).

Qepore: kundër tripseve, noktuideve, me 50-133 ml/hl (500 ml/ha).

Argjinar: kundër noktuideve, me 50-133 ml/hl (500 ml/ha).

Jonxhë: kundër afideve, birueses së jonxhes (*Hypera postica*), me 50-133 ml/hl (500 ml/ha).

Rrepë: kundër afideve, me 83 ml/hl (500 ml/ha).

Lule dielli: kundër afideve, noktuideve, me 83 ml/hl (500 ml/ha).

Lule shtrydhe: kundër afideve, noktuideve, me 50-133 ml/hl (500 ml/ha).

Lakër, lule laker, brokoli: kundër afideve, krimbit të lakres, noktuideve, tenjes së lakres, me 50-133 ml/hl (500 ml/ha).

Sallatë, spinaq, çikore: kundër afideve, noktuideve, me 50-133 ml/hl (500 ml/ha).

Leguminoze: kundër afideve, noktuideve, me 50-133 ml/hl (500 ml/ha).

Misë: kundër krimbit, noktuideve, afideve, diabrotikes, me 50-100 ml/hl (500 ml/ha).

Në kultura pyjore, livadhe, kullota etj: kundër fitofagëve të ndryshëm dhe karkalecave, më 500 ml/ha.

Norma e solucionit sperkatës është 300-600 lit/ha në perime dhe kulturat fushore dhe deri 1000 lit në pemëtari e vreshta.

Pregatitja e solucionit spërkatës: DELMUR hollohet fillimisht në pakë ujë, hidhet në depozitë dhe, duke e përzier, mbushet me volumin e caktuar të ujit.

Vërejtje për përdorimin:

Mos trajtoni në ditë me erë. Trajtimet fillojnë me shfaqjen e infeksioneve të para. Përzihet me të gjitha PMB-të dhe ushqyesit gjethorë, me përjashtim të atyre me reaksion alkaline. Mos kryeni më shumë se dy trajtime/sezon. DELMUR është prepart kontakti, prandaj duhet të sigurohet lagje uniforme dhe e mjaftueshme e masës vegjetative.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik në kulturat dhe dozat e rekomanduara në këtë etiketë.

Ndikimi në ekosistem:

H410: Shumë helmues dhe me efekte afatgjatë ndaj organizmave ujore. Mos ndotni ujin me produktin ose enën e tij. Shmangni kontaminimin përmes sistemeve të kullimit të ujrave në ferma dhe rrugë. Për mbrojtjen e gjallesave ujore mos trajtoni në parcelat të cilat janë më pakë se 20 m larg sipërfaqeve ujore. Mos pastro mjetet e aplikimit në afersi të ujërave sipërfaqësore. Enët e përdorura i zbrazni plotësisht dhe nuk duhet ti shpërndani në mjedis. Ambalazhet bosh nuk duhet të ripërdoren.

I rrezikshëm për bletët dhe insektet pjalmuese. Nuk duhet të përdoret gjatë lulëzimit dhe periudhës së polenizimit, kur bletët janë në aktivitet. Të luftohen barërat e këqija përpara periudhës së lulëzimit. Gjate dhe pas aplikimit, bletët duhet të rrinë në kosheret për disa ditë me ushqim e ujë të mjaftueshëm ose të largohen në një distancë të paktën 3 km. Për të mbrojtur insektet e dobishme, mos e trajtoni kulturën në një fashë prej 5 m të gjerë në njërën skaj të parceles.

Karenca:

Trajtimi fundit para vjeljes: Lule dielli 60 ditë; rrepa 45 ditë; agrumet, bajamja, misri, 30 ditë; jonxha, 14 ditë; pemët frutore, rrushi, patatja, lakra, lule lakra, fasulja, hudhra, qepa, prasi, 7 ditë; domate, spec, patëllxhan, kastravec, kunguj, shalqin, pjepër, perime gjethore, 3 ditë.

Magazিনি:

Të ruhet në temperaturë 5-45⁰ C, në vënde të freskëta e të thata, të ajrosura mirë.

Nr. dhe data e regjistrimit: 728, datë 24.4.2020.

Data e prodhimit:

Periudha e ruajtjes: 3 vjet

Numri i serisë:

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin bazë: 5 ml, 10 ml, 50 ml, 100 ml, 1 lit.

Tipi i ambalazhit bazë: shishe COEX ose HDPE.

Aplikanti: RAINBOW AGROSCIENCES EUROPE, S.A.U., **Adresa:** Pol. Ind. Fondo de Litera, Autovía A-2 Km 441.6 22520 Fraga (HUESCA) SPANJË.

Prodhuesi: 1. RAINBOW AGROSCIENCES EUROPE, S.A.U. **Adresa:** Pol. Ind. Fondo de Litera, Autovía A-2 Km 441.6, 22520 Fraga, (HUESCA) SPANJË.

2. SHANDONG WEIFANG RAINBOW CHEMICAL CO. LTD, **Adresa:** Binhai Economic Development Area, Weifang, Shandong 262737, KINË.